



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME Nr. 2 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 17/07/2018

**Për:** Shoqërinë "ELECTRICAL POWER ENGINEERING" sh.p.k, me NUIS K81511012V, me adresë rruga " Teodor Rusvelt", pallati Nelsi, kati I, lagja Selitë, Farkë, Tiranë

**Procedura e prokurimit:** Procedurë e Hapur.

**Numri i referencës së procedurës :** REF-71634-05-28-2018

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** "Blerje materiale për ndriçimin publik" afati: 15 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës

**Publikime të mëparshme (nëse zbatohet):** Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 22, Date 04.06.2018.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Operatori ekonomik "RA-MI KOMPANI" sh.p.k, me NUIS L61327009F dhe me ofertë ekonomike 35.991.380 (tridhjetë e pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik "ELECTRICAL POWER ENGINEERING" sh.p.k, me NUIS K81511012V dhe me ofertë ekonomike 38.497.720 (tridhjetë e tetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e njëzetë) lekë pa tvsh.
3. Operatori ekonomik "ITE Grup" sh.p.k, me NUIS K11323001H dhe me ofertë ekonomike 39.130.380 (tridhjetë e nëntë milion e njëqind e tridhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh.
4. Operatori ekonomik "A BI ESSE" sh.p.k, me NUIS J61818010A dhe me ofertë ekonomike 42.283.762 (dyzetë e dy milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa tvsh.

### Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik "RA-MI KOMPANI" sh.p.k, me NUIS L61327009F
2. Operatori ekonomik "ITE Grup" sh.p.k, me NUIS K11323001H
3. Operatori ekonomik "A BI ESSE" sh.p.k, me NUIS J61818010A

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

## **I. Operatori Ekonomik "RA-MI KOMPANI" sh.p.k :**

### **1. Nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim si mëposhtë:**

- a) Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.5 **Kapaciteti teknik**: “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 50001-2011** (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO)” pasi ISO e paraqitur nuk është e akredituar.
- b) Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.9 **Kapaciteti teknik**: “Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrat e mallrave të pasqyruara në tabelën e mëposhtme pranë Drejtorisë së Përgjithshme nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit në datën dhe orën e tenderit. Mosparaqitja e tyre përbën kusht për skualifikim” pasi operatori ekonomik nuk u paraqit në vëndin dhe orën e përcaktuar për dorëzimin e mostrave.
- c) Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin për **Specifikimet teknike** si vijon:
  - Artikulli “Lampa SON T 250W” është ofruar me 32,000 orë pune nga 40,000 që është kërkesa.
  - Artikulli “Lampa SONT T 150W” është ofruar me 17,000 lumen dhe 32,000 orë pune nga 17,600 lumen dhe 40,000 orë pune që është kërkesa.
  - Për Artikullin “Lampa NAV TS 150W” është ofruar Artikulli “0020232” Quartz Metal Halide dhe jo Natrium (Sodium) sipas kërkesës.
  - Për Artikullin “Lampa NAV TS 70W” është ofruar Artikulli “0020230” Quartz Metal Halide dhe jo Natrium (Sodium) sipas kërkesës.

## **II. Operatori Ekonomik "ITE Grup" sh.p.k :**

### **1. Nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim si mëposhtë:**

- a) Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.1 **Kapaciteti teknik**: “Furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit **nga data e zhvillimit të tenderit**, të aktivitetit të operatorit, në vlerën prej jo më pak se 40% e fondit limit, të vënë në dispozicion përkatësisht: 18,064,684 (tetëmbëdhjetë milion e gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH.

*Këto furnizime të së njëjtës natyrë do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

*Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate dhe faturat me tvsh.*

### **OSE**

*Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur fatura tatimore shitje, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara”, pasi vlera totale e furnizimit është 14.859.086 ose 32.9%.*

- b) Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.10 **Kapaciteti teknik**: “Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës” pasi çertifikata e kontrollit teknik është jashtë afateve ligjore.

### III. Operatori ekonomik "A BI ESSE" sh.p.k :

#### 1. Nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim si mëposhtë :

- a) Operatori ekonomik nuk plotëson pikën **2.3.7 Kapaciteti teknik**: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001-2008 të prodhuesit / distributorit të mallrave, objekt prokurim”* pasi ISO e SCHNEDER është e skaduar.
- b) Operatori ekonomik nuk plotëson pikën **2.3.8 Kapaciteti teknik**: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogjet e prodhuesit për mallrat që janë objekt prokurim”* pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur katalog për zërin 41 - Elektrode Togëzimi + Bulon Togëzimi.
- c) Operatori ekonomik nuk plotëson pikën **2.2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar**: *“Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin (2017, 2018) edhe për vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit, sipas ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit pasi ne ekstraktin e Q.K.B”* pasi subjekti ka adresë sekondare në Durrës, Ishem, Ndërtimi i Linjës Kolektorit dhe Impianti i Trajtimit të Ujrave të Perdorura (I.T.U.P), dhe për këtë duhet të pajisej me vërtetim për shlyerjen e taksave vendore në Bashkinë Durrës.
- d) Operatori ekonomik nuk plotëson pikën **2.3.9 Kapaciteti teknik**: *“Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrat e mallrave të pasqyruara në tabelën e mëposhtme pranë Drejtorisë së Përgjithshme nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit në datën dhe orën e tenderit. Mosparaqitja e tyre përbën kusht për skualifikim”* pasi operatori ekonomik nuk u paraqit në vëndin dhe orën e caktuar për dorëzimin e mostrave.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë "ELECTRICAL POWER ENGINEERING" sh.p.k, me NUIS K81511012V, me adresë rruga " Teodor Rusvelt", pallati Nelsi, kati I, lagjja Selitë, Farkë, Tiranë se oferta e paraqitur , me një vlerë të përgjithshme prej 38.497.720 (tridhjetë e tetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e njëzetë) lekë pa tvsh është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, Rruga 5 Maji, Tiranë** sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i kontratës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 09.07.2018.

Ankesa: Nuk ka.